



VENDIM

K.P.P. 793/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.11.2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje”, me nr. REF-88605-10-04-2018, me fond limit 6,150,964 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.10.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k.
Adresa: Njësia Tregtare nr.3, Blloku Gintash, Laprakë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.
Adresa: Rr. “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 05.10.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje”, me nr. REF-88605-10-04-2018, me fond limit 6,150,964 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.10.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

II.2 Në datën 15.10.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 18.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Sulollari" shpk	pa ofertë ekonomike	Skualifikuar;
2. "Paera" shpk	5,635,700 lekë	Skualifikuar;
3. "Bolt" shpk	5,893,332 lekë	Skualifikuar;
4. "Climacasa" shpk	6,038,250 lekë	Kualifikuar;

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "Bolt" sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

"Nuk plotëson pikën i) të kapacitetit teknik pasi Raporti i Testimit i paraqitur nuk është i lëshuar brenda 12 muajve të fundit sipas kërkesave të DST por më datë 06.05.2016 dhe ky raport testimi nuk është paraqitur i njehsuar me origjinalin në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.7829, datë 01.09.194 "Për noterinë" por vetëm vërtetim përkthimi."

II.5.Në datën 24.10.2018 operatori ekonomik ankimues "Bolt" sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, si dhe ngre pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik "Climacasa" sh.p.k..

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1797/4 Prot. datë 29.10.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Bolt" sh.p.k., duke mos pranuar ankesën.

II.7.Në datën 07.11.2018 operatori ekonomik ankimues "Bolt" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Duke qene se ne Shqiperi nuk ekzistojne laboratore analizash te akredituara (per analiza pelleti),kjo mund te konfirmohet lehte nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit ne kemi paraqitur raport testimi nga kompani Italiane te certifikuar dhe akredituara te cilet keto raporte testimi i leshojne per nje periudhe vlefshmerie tre vjecare, pasi kostoja e tyre eshte teper e larte(minimalisht 5000 Euro). Ne pranojme faktin qe ne DST ju keni kerkuar analiza per nje periudhe 12 mujore, por ne mostren qe ne kemi paraqitur, analizat e bera nga SIBE S.r.l me raport nr. 187/2016 jane te stamposura dhe ne thesin e paraqitur si kampion mostre, produkt qe do te ofrohet dhe ne kushtet e pas lidhjes se kontrates. Gjithashtu nuk duhet te meret ne konsiderate dhe lapsusi i njesimit me origjinalin nga zyra noteriale. Ne kete aspekt mendojme qe KVA duhet te merte per baze LPP Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, deri ne Ligjin Nr. 47/2017, NENI 53 Shqyrtimi i ofertave, Pika 4 Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, nisur dhe nga oferta e kenaqshme ekonomike.

b) Gjithashtu ne njohim operatoret qe operojne ne prodhimin dhe tregtimin e pelletit. Ne kete kendveshtrim, Operatori Climacasa i kualifikuar me oferte me te larte ekonomike nuk ploteson ne gjykimin tone kerkesat e vecanta per kualifikim dhe me konkretisht:

1. Pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo me pak se 40 % të fondit limit, të realizuara gjate 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat detyrimisht duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shenohen datat, shumat, emërtimet, vlerat dhe sasitë e mallrave. b) Per furnizime te realizuara me subjekte private operatori ekonomik te paraqese faturat tatimore te shitjes, (ku te

shprehen qarte datat, shumat, sasite, emertimet, vlerat). Sipas pergjigjes se dhene per kete pike KVA sakeson qe operatori ekonomik Climacasa shpk ka paraqitur kontrate te ngiashme te dates 23.01.2018 me vlere 7 692 926.1 leke, kontrate e cila i perket ketij viti ushtrimor aktiviteti dhe si e tille nuk mund te merret ne konsiderate, pasi nuk pasqyrohet dhe ne bilancet e kerkuara.

2. Pika 2.3. Kapacitetiteknik: *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar per mallrat objekt prokurimi si perfaqesues i kompanise prodhuese per te gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi. Ne rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik duhet te paraqesi ne leter angazhim ose akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail,   bbsite kjo e nevojshme per autoritetin kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.(dokumentacioni te paraqitet ne gjuhen shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar) Diten e hapjes se ofertave mostra e paraqitur tregonte prodhues Italian dhe Distributor Letonez dhe nuk kishte asnje lidhje mes firmes prodhuese dhe firmes Ofertuese, gje e cila u pranua dhe nga perfaqesuesit e firmes. Sipas KVO eshte paraqitur autorizim prodhuesi ne dokumentat e hedhura ne sistem, por firma qe autorizon kompanine Climacasa shpk nuk eshte e njejta me mostren (thesi prej 15 kg) e paraqitur nga perfaqesuesit e kesaj firme ditën e hapjes se procedures.

3.Operatori ekonomik ofertues duhet te jet   pajisur me   ertifikaten ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit te cilesise, e cila t   p  rfshij   objektin e prokurimit, si dhe t   jet   e vlefshme.(dokumentacioni te paraqitet ne gjuhen shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

4.Operatori ekonomik ofertues duhet te jet   pajisur me   ertifikaten ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit t   mjedisit, e cila t   p  rfshij   objektin e prokurimit, si dhe t   jet   e vlefshme.(dokumentacioni te paraqitet ne gjuhen shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar). Ne kemi bindjen e polte se ky Operator ekonomik ka certifikatat e mesiperme, por nuk i ka me emertesën blerje ose prodhim pelleti (duke qene se ka autorizim prodhuesi) duhet detyrimisht qe ne certifikate te kete tregtim pelleti[...]

II.8.N   dat  n 19.11.2018 autoriteti kontraktor me an   t   shkres  s nr.1947/1prot., dat   16.11.2018, ka dor  zuar pran   Komisionit t   Prokurimit Publik informacionin e k  rkuar n   lidhje me procedur  n e prokurimit t   sip  rcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit t   ankes  s, dhe pretendimeve t   operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Bolt" sh.p.k. mbi skualifikimin e ofert  s s   tij, n   procedur  n e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : "[...]Nuk plot  son pik  n i) t   kapacitetit teknik pasi Raporti i Testimit i paraqitur nuk   sht   i l  shuar brenda 12 muajve t   fundit sipas k  rkeseve t   DST por m   dat   06.05.2016[...]", Komisioni i Prokurimit Publik v  ren se:

III.1.1. Në pikën 2.3.i të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimit nga laboratorë të certifikuar me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara për mallrat objekt prokurimi. Dëshmia me rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar jo më parë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e zhvillimit të tenderit. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe noterizuar)”

III.1.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), Raport Analizë nr.187/2016, datë 06.05.2016, lëshuar nga SIBE S.r.l., për mostrën *Pellet* ahu.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.4. Në nenin 27, pika 6 gërma c të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me raportet e testimit nga laboratorë të certifikuar për artikullin objekt prokurimi, vëren se operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k ka paraqitur një raport/fletë analizë të lëshuar në datën 06.05.2016 nga SIBE S.r.l., në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.i të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi kjo fletë analizë nuk është lëshuar brenda 12 muajve nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, por është lëshuar rreth 31 muaj nga data e zhvillimit të saj. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, me anë të kriterit të mësipërm, qëllimi i autoritetit kontraktor është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në përputhje me nenin nenin 27, pika 6, gërma c, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, zotërojnë artikullin objekt prokurimi në përputhje me kërkesat, specifikimet teknike dhe cilësinë e vendosur nga autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, pretendimi i ankimuesit se vlefshmëria e fletë-analizës të paraqitur prej tij është 3-vjecare, është e pabazuar, pasi nga shqyrtimi i fletë-analizës nr.187/2016, datë 06.05.2016, rezulton se nuk citohet në asnjë rast ky fakt. Komisioni thekson se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.i të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”.

III.1.6. KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për ofertuesit e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Në këto kushte, pretendimet e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” sh.p.k, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt “*Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje*”, me nr. REF-88605-10-04-2018, me fond limit 6,150,964 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.10.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1694 protokolli Datë 07.11.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha